



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 3

Prishtinë, më 29 mars 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Muhamet Mustafa dhe Albert Kinolli,

Mungoi: Afrim Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatore, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe i financave, KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari e Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.03.2011,
3. Shqyrtimi i Propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2011,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 mars 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23 mars 2011.

3. Shqyrtimi i Propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2011,

Kryesuesi – Tha se në përgjithësi sipas Propozimplanit të punës, ky komision do të merret me tri lloje të raporteve të auditimit: të menaxhmentit, të rregullsisë dhe të performancës. Lidhur me auditimin e KEK- ut, që ka paraparë ZAP- i, nuk mendoj që duhet të jetë auditim i rregullsisë, por auditim i performancës. E hapi diskutimin.

Muhamet Mustafa – ZAP –i mund të rekomandoj, por ky komision mund të marrë vendime të tjera. KMFP- ja ka një përgjegjësi pak më të gjerë, e jo të merret ekskluzivisht vetëm me raportet ZAP- it.

Armend Zemaj – Tha se deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe Komisioni Funkcional për një çështje, ka mandatin e plotë për t'u zgjeruar edhe jashtë asaj që quhet “*pavarësi e një institucioni*”. KMFP mund të kontrollojë çdo organizatë buxhetore, e cila ka të bëjë me parane publike. Propozoj që në të ardhmen të shikohet kjo kompetencë dhe të sqarohet.

Ligji për ndërmarrjet publike ka një nen, sipas të cilit ndërmarrjet publike kanë të drejtë që të zgjedhin vetë auditorin e jashtëm. Ndoshta do të ishte mirë që të iniciohet procedura për ndryshimin e këtij ligji.

Muhamet Mustafa – E falënderoj stafin për përgatitjen e Propozimplanit të punës. Mënyra e përgatitjes së tij tregon se ky komision do të kryejë rolin e vetë më seriozitet. Është shumë me rëndësi të kontrollohet nëse paraja publike shkon në destinimin e paraparë nga Kuvendi me buxhet dhe i njëjti trajtim vlen edhe për ndërmarrjet publike.

Ai ngriti çështjen e transfereve sociale. Pësia e pakos sociale po bëhet tejet e rëndë. Nuk është diskutabile se kjo kategori i njerëzve duhet mbështetur. Por, a jemi të sigurt që gjithë ky numër i njerëzve kanë gjendje të tillë sociale, që të kualifikohen për të marrë mbështetje sociale? Një informatë lidhur me këtë është jashtëzakonisht me rëndësi për Kosovën dhe për përdorimin me përgjegjësi të parasë publike.

Ramiz Lladrovci – Lidhur me çështjen e ngritur nga deputeti Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit se është e vërtetë që ka njerëz që marrin përfitime nga këto transfere sociale të cilët nuk e meritojnë, por ekziston një Komision i përbërë prej Qeverisë dhe Kuvendit për t'i kontrolluar të gjitha transferet. Po ashtu i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka njerëz të cilët janë plagosur në luftë dhe nuk përfitojnë nga kjo, pavarësisht që ligji ju garanton një gjë të tillë. Këta njerëz duhet të figurojnë si njerëz të plagosur në luftë. Ndau mendimin që kjo duhet kontrolluar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Lidhur me auditimin e KEK- ut ndau mendimin me deputetin Armend Zemaj se KMFP është Komision parlamentar dhe se si i tillë ka të drejtë të kontrollojë çdo gjë që ka të bëjë me buxhetin e Kosovës.

Valbona Dibra – Ndau mendimin me parafolësit. ZAP- i e përcakton llojin e auditimit të organizatave buxhetore, duke mos i mundësuar entitetit që të vendosë vetë për llojin e auditimit. Po ashtu ZAP- i e merr në konsideratë çdo kërkesë për auditim.

Armend Zamaj – Tha se çështja e skemës sociale duhet të shikohet në përgjithësi si “skemë sociale”, jo të lidhet me kategori të caktuara. Ligji për skemën sociale është tentuar të ndryshohet disa herë - një herë është ndryshuar. Komisioni mund të monitorojë në radhë të parë ligjin, në mënyrë që të marrë informata se sa është duke u zbatuar ligji i tanishëm, pastaj të japë rekomandime për ministri. Sipas ligjit, çdo 6 muaj rishqyrtohet skema sociale.

Valbona Dibra – Plani i punës është përgatitur në bazë të planit të ZAP- it për publikim të raporteve. Kjo është paraparë vetëm deri në muajin korrik. Pyeti, si është përgatitur plani nga muaji shtator e tutje?

Kryesuesi - Lidhur me shqyrtimin e pasqyrave financiare të audituara të ZAP- it për vitin 2008 dhe 2009, tha se ky komision ndoshta nuk është kompetent të merret me to, duke pasur parasysh që është fjala për pasqyra të vitit 2008 dhe 2009. Cili do të jetë efekti i këtij auditimi? E hapi diskutimin.

Armend Zamaj – Tha edhe pse efekti i këtyre raporteve nuk mund të dihet prapëseprapë Komisioni mund t'i shqyrtojë si vazhdimësi, së bashku me pasqyrat e audituara financiare të vitit 2010.

Valbona Dibra – Ndau mendimin me deputetin Armend Zemaj, sepse kjo do t'i ndihmonte Komisionit se si kanë ndodhur zhvillimet.

Armend Zamaj - Propozoi që me qëllim të shkëmbimit të përvojave Komisioni të vizitojë Këshillin e Lartë të Kontrollit në Shqipëri.

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se ka pranuar një letër nga Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, të cilët kërkojnë që Kuvendi i Kosovës të themelojë një komision për auditimin e aktiviteteve dhe veprimeve të kryetarit të Bordit të RTK- së, për moszbatimin e kodit, rregullores, si dhe të vetë programit të RTK- së. Ankesa ka të bëjë më atë që në skemat programore të RTK- së nuk u jepet hapësirë ndërtimeve pa leje dhe parregullsive të tjera urbanistike.

Komisioni mund të kërkojë nga ZAP- i që të auditojë pasqyrat specifike të RTK- së.

Propozoi që pjesë e planit të punës duhet të jenë edhe veprimet e Komisionit për vërejtjet e Raporti të Progresit që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e këtij komisioni. Këto çështje, ishte i mendimit, të trajtohen në muajin prill, duke pasur parasysh që gjashtëmujori i parë i punës së Komisionit do të jetë shumë i ngarkuar. E hapi diskutimin.

Armend Zemaj – Tha se asnjëherë me RTK- në nuk kanë arritur të sqarohen raportet financiare. Themelues i RTK- së është Kuvendi, ndërsa paraja gjendet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Komisioni duhet të kujdeset që këto para të shpenzohen si duhet. Duke filluar nga raportet financiare. Me skemën programore merret Komisioni i veçantë funksional i Kuvendit.

Lidhur me propozimin që çështjet e parapara në Raportin e Progresit të përfshihen në plan të punës tha se Raporti i Progresit është në përfundim e sipër edhe për vitin 2010. U pajtua që shqyrtimi i këtyre çështjeve të bëhet në muajin prill.

Ramiz Lladrovci – Lidhur me RTK- në tha se Komisioni mund të kërkojë raport nga RTK- ja dhe nga të gjitha organizatat buxhetore çdo tre muaj. RTK- ja është e detyruar që të raportojë në baza tre mujore në Ministri.

Mursel Halilji – Meqenëse puna e Komisionit është e ndërlidhur me punën e ZAP- it, edhe plani i punës duhet të harmonizohet me planin e punës së ZAP- it. Ky komision është ndër komisionet më të rëndësishme, kemi të bëjmë me kontrollin e parasë publike. Ne duhet të fokusohemi në punën e ZAP- it.

Kryesuesi konstatoi se të pranishëm janë gjashtë deputetë dhe me **gjashtë vota për** dhe **asnjë kundër**, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Plan i punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e financave publike për vitin 2011.*
2. *Në Plan të Punës përfshihen për trajtim edhe vërejtjet e Raportit të Progresit, që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.*

3. *Shqyrtimi i raportit të auditimit të pasqyrave financiare të ZAP- it për vitin 2008 dhe 2009 do të bëhet atëherë kur në Komision do të shqyrtohet raporti i auditimit të pasqyrave financiare të ZAP-it, për vitin 2010.*

5. Të ndryshme

Kryesuesi njoftoi anëtarët e Komisionit se do të organizohet një mbledhje e veçantë vetëm me Auditorin e Përgjithshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu